

Raport nga vëzhgimi dhe analiza e punës së Këshillave të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale

Projekti:

**“Standarde për mirëmbajtjen e përgjegjësisë,
transparencës dhe kooperativitetit të
vetëqeverisjes lokale”**

Të dhënat e prezantuara në raport nuk i pasqyrojnë mendimet dhe qëndrimet e donatorëve të projektit.

Projekti "Standarde për qëndrueshmëri të Vetëqeverisjes lokale të përgjegjshme, transparente dhe bashkëpunuese" realizohet në kuadër të programit CIVICA Mobilitas të cilën e realizon Qendra për zhvillim institucional (CIRa) dhe është i financuar nga Agjencioni Zvicëran për zhvillim dhe bashkëpunim, e përfaqësuar nga Zyra për bashkëpunim në Maqedoni.

Copyright©2012, Asociacioni qytetar MOST. Të gjitha të drejtat janë të mbajtura. Është e ndaluar shfrytëzimi dhe reproduktimi i cilësdo pjesë nga raporti, pa leje nga Asociacioni qytetar MOST.

Për projektin

Me qëllim që të kontribuojë për transparencë të madhe, përgjegjësi dhe udhëheqje të mirë të vetëqeverisjes lokale dhe ngritje të ndërgjegjes së qytetarëve për punën e këshillave të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (NJVL), Asociacioni qytetar MOST në periudhën janar 2011 – mars 2012 e realizoi projektin “Standarde për mirëmbajtjen e përgjegjësisë, transparencës dhe kooperativitetit të vetëqeverisjes lokale”.

Në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, organet e komunave kanë për detyrë që t’i informojnë qytetarët për punën, aktivitetet, planet dhe programet e tyre.

Edhe pse procesverbali i mbledhjeve të mbajtura të këshillave të NJVL-së është obligim ligjor i Këshillave të NJVL-së, i njëjti është mjet i rëndësishëm për informimin e qytetarëve për punën e Këshillave të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (NJVL). Procesverbali nga mbledhjet e mbajtura të këshillave bën pjesë në kategorinë e informacioneve të karakterit publik dhe në pajtim me ligjin është në dispozicion edhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Procesverbali paraqet dokument zyrtar, i cili bazohet në fakte e dokumente dhe i përmban të dhënat themelore për punën e mbledhjeve, propozimet që janë parashtruar, përfundimet që janë miratuar dhe vendimet që janë marrë në lidhje me pyetjet nga rendi i ditës së mbledhjeve të Këshillave të NJVL-së.

Në projektin u përfshinë të gjitha 85 NJVL, përmes realizimit të këtyre aktiviteteve:

1. Përgatitja dhe prezantimi i kriterëve dhe standardeve për mënyrën e përpilimit dhe qasshmërisë së procesverbaleve për punën e Këshillave të NJVL-së – prezantimi i kriterëve dhe standardeve para kompetentëve në të gjitha 85 NJVL;
2. Parashtrimi i kërkesave për dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të NJVL-së në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informacione të karakterit publik;
3. Vëzhgimi i qasshmërisë në procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të NJVL-së në faqet zyrtare të internetit të NJVL-së, si dhe në dërrasat (tabelat) për shpallje në komunat dhe në bashkësitë urbane/rurale;
4. Promovimi i internet-mjetit për qasje të lehtë dhe të shpejtë deri te procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit të NJVL-së (www.mojotsovetnik.org.mk); resurs/faqe interneti në të cilën mund të gjenden të gjitha procesverbalet e dërguar në kuadër të vëzhgimit të punës së këshillave të NJVL-së.

5. Analiza dhe përpilimi i procesverbaleve nga mbledhjet e këshillave sipas aplikimit të standardeve themelore për mbajtjen e të njëjtave;
6. Përpilimi, promovimi dhe shpërndarja e Doracakut për aplikimin e standardeve për mbajtjen e procesverbalit nga mbledhjet e Këshillit të NJVL-së në bashkëpunim me Bashkësinë e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL);
7. Prezantimi, promovimi dhe shpërndarja e raportit nga vëzhgimi i punës së Këshillave të NJVL-së në opinion;

Metodologjia e grumbullimit të të dhënave

Gjatë realizimit të projektit u mbajtën 70 takime me përfaqësues të komunave në territorin e Republikës së Maqedonisë, me qëllim të njoftimit me lëndën e vëzhgimit dhe prezantimit të metodologjisë së zhvilluar të grumbullimit dhe përpilimit të të dhënave të marra. Në këto takime ishin prezentë 45 kryetarë të komunave, 22 kryetarë të këshillave komunale dhe 36 sekretarë komunalë, përfaqësues të sektorëve të ndryshëm dhe persona përgjegjës për informacione të karakterit publik.

Në pajtim me Ligjin për qasje në informacione të karakterit publik u parashtruan gjithsej 345 kërkesa për qasje në informacione për të gjithë 85 NJVL. Kërkesat kishin të bënin me procesverbalet e miratuara nga mbledhjet e këshillave të mbajtura në periudhën, dhjetor 2010 – dhjetor 2011. Në analizën u përpunuan të dhënat nga mbledhjet, që u dërguan në MOST deri në 31 mars të vitit 2012.

Si përgjigje e këtyre kërkesave, janë marrë gjithsej 982 procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të 81 NJVL.

Pozitivisht u përgjigjën 81 NJVL në kërkesat për qasje në informacione të karakterit publik dhe i dërguan procesverbalet e kërkuara, ndërsa 4 NJVL – Qendra, Çuçer Sandeva, Zelenikova dhe Demir Hisari nuk dërguan procesverbale nga mbledhjet e këshillit.

Këshilli i Komunës së Çuçer Sandevës, me propozim të kryetarit, ka shqyrtuar kërkesën për qasje në informacione të karakterit publik e dërguar nga Asociacioni qytetar MOST, si dhe informacionin për projektin dhe qëllimet e tij. Këshilli mori vendim që të përgjigjet negativisht në kërkesën për qasje në informacione të karakterit publik, për çka përmes telefonit e njoftoi MOST-in.

Komuna e Demir Hisarit i dërgoi shkresë zyrtare MOST-it, në të cilën e informoi për vendimin e marrë të Këshillit, ku thuhet se komuna nuk ka për detyrë të dërgojë procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të këshillit.

Nga komunat Qendra dhe Zelenikova nuk morëm asnjë shpjegim për arsyen se pse nuk na i dërguan procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të këshillit.

Për nevojat e këtij monitorimi dhe analize, të dhënat e marra nga komunat Kisella Voda dhe Bërvenica, janë trajtuar ashtu siç janë marrë.

Edhe pse komuna Kisella Voda pozitivisht iu përgjigj kërkesave për dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të këshillit dhe dërgoi 13 procesverbale, të dhënat në to nuk janë të tërësishme. Domethënë, në të gjitha procesverbalet vërehet se emrat dhe mbiemrat e këshilltarëve dhe të personave tjerë prezentë në mbledhjet janë fshirë me korrektor (zbardhues) për ngjyrë.

Komuna e Bërvenicës në kërkesën e parë të parashtruar u përgjigj tërësisht dhe dërgoi 2 procesverbale zyrtare. Në rrjedhën e mëtejme të procesit, komuna e Bërvenicës dërgonte përgjigje të kërkesave në formë të ngjashme me origjinalin, përkatësisht përgjigjet përmbanin vetëm fragmente nga procesverbalet zyrtare.

Të dhënat për qasshmërinë në procesverbale për qytetarët u mblodhën nga ana e 19 vëzhguesve rajonalë.

Lënda e analizës dhe metodologjisë së përpunimit të të dhënave

Lëndë e vëzhgimit dhe analizës janë dy nga disa elemente themelore të funksionimit të NJVL-së në drejtim të transparencës, përgjegjësisë dhe kooperativitetit të mirëmbajtur ndaj qytetarëve. Ata janë:

- Vëzhgimi i qasshmërisë në procesverbalet nga mbledhjet e këshillave të NJVL-së për qytetarët; dhe
- Vëzhgimi i suksesshmërisë në aplikimin e standardeve për mbajtjen e procesverbaleve nga mbledhjet e këshillave të NJVL-së;

Grumbullimi i të dhënave për qasshmërinë në procesverbale për qytetarët u realizua nga ana e 19 vëzhguesve rajonalë, përmes vizitës së faqeve të internetit të komunave, si dhe përmes vizitave në terren të bashkësive urbane/rurale, duke konstatuar qasshmërinë në procesverbale në dërrasat (tabelat) e shpalljes.

Të dhënat nga procesverbalet e marra u analizuan përmes prizmës së tre standardeve kyçe që rrjedhin nga aktet ligjore dhe rregulloret për punën e këshillave të NJVL-së:

1. Evidencë për prezencë në mbledhje;
2. Evidencë për rezultate nga votimi;
3. Evidencë për fjalime të diskutuesve.

Gjatë analizimit të procesverbaleve, metodologjia u adaptua me gjendjen faktike dhe për këtë arsye këto tre standarde janë të mbështetura me 31 praktika plotësuese të ndryshme të përdorimit të tyre nga ana e NJVL-së gjatë mbajtjes së procesverbaleve të këshillit. Përmes pasqyrës së këtillë detale kuantitative janë marrë edhe tregues cilësor për shkallën e suksesshmërisë të aplikimit të standardeve nga ana e NJVL-së.

Bazat e të dhënave janë azhuruar dhe prezantuar në tre nivele.

Niveli i parë jep pasqyrë për mënyrën e aplikimit të tre standardeve, duke përfshirë edhe 31 praktikat e ndryshme të aplikimit për çdo procesverbal të marrë veçmas nga ana e NJVL-së.

Niveli i dytë jep pasqyrë përmbledhëse për mënyrën e aplikimit të standardeve në secilën nga 8 kategoritë¹ e NJVL-së të definuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale veçmas.

Niveli i tretë jep pasqyrë/ rang-listë për secilën nga 8 kategoritë veçmas, në bazë të 3 renditjeve edhe atë: Evidenca për prezencë, evidenca për votim dhe evidenca për

¹ Komunitat janë ndarë në kategori sipas numrit të banorëve.

fjalime. Renditja është bërë ashtu që është llogaritur për çdo komunë veçmas, përqindja e realizimit të çdo standardi në bazë të përdorimit të praktikave të mira. Gjatë renditjes së përgjithshme është marrë vlera mesatare e përqindjes së realizimit të standardeve.

Përpunimi teknik i të dhënave dhe shënimi i 38.298 të dhënave në secilin nga nivelet u realizuan vazhdimisht pas analizës së kryer në secilin prej 982 procesverbaleve nga mbledhjet e këshillave të NJVL-së.

Gjatë azhurimit dhe përpunimit të të dhënave u plotësua edhe resursi ekzistues i internetit www.mojotsovetnik.org.mk. Për shkak të prezantimit transparent, të argumentuar dhe të paanshëm të fakteve në këtë faqe të internetit, mund të gjenden të gjithë 982 procesverbale të dërguar nga ana e 81 NJVL për periudhën e vëzhgimit.

Në këtë raport janë prezantuar vetëm rang-listat për suksesshmërinë e realizimit të standardeve. Të dhënat në bazë të të cilave është kryer renditja, përkatësisht për çdo komunë veçmas, si dhe pasqyra përmbledhëse sipas kategorive të komunave janë të qasshme në faqen e internetit www.mojotsovetnik.org.mk.

Rezultatet nga vëzhgimi i qasshmërisë në procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të NJVL-së

Vëzhgimi për qasshmërinë në procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të NJVL-së në faqet zyrtare ekzistuese të internetit të gjithsej 72 NJVL i konstatoi këto fakte:

- Gjithsej 66 komuna në faqet e tyre të internetit aspak nuk kanë procesverbale nga mbledhjet e mbajtura të këshillave;
- Komuna e Vasilevës rregullisht i shpall procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura në faqen e saj të internetit;
- Gjevgjelia dhe Vinica i shpallin vetëm procesverbalet nga mbledhjet e fundit të mbajtura;
- Çashka, Sopishta dhe Prilepi i kanë shpallur procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të këshillit nga vitet e mëparshme (2008 - 2010), por jo edhe të vitit 2011;
- 31 NJVL e shpallin Rendin e ditës të mbledhjeve të caktuara të këshillit, përderisa 41 NJVL të njëjtin nuk e shpallin;
- 30 NJVL e shpallin Fletoren zyrtare në faqet e tyre të internetit, përderisa tek 42 NJVL Fletorja zyrtare ose nuk shpallet ose linqet nuk janë aktive ose shpallen numra të vjetra të fletoreve zyrtare.

13 NJVL nuk kanë faqe të internetit ose të njëjtat janë në përpunim ose nuk janë aktive (Karbinci, Llozova, Likova, Studeniçani, Zelenikova, Krivogashtani, Debarca, Qendra Zhupa, Zajazi, Vraneshtica, Pllasnica, Çuçer-Sandeva dhe Shuto Orizari);

Sa i përket qasshmërisë në procesverbale në bashkësitë urbane/ vendore, shumica e NJVL-së si praktikë e tregojnë sigurimin e procesverbaleve të bashkësive urbane/ vendore vetëm me kërkesën e tyre.

Në përgjithësi pasqyra për qasshmërinë në procesverbale për qytetarët sipas njohurive të lartpërmendura tregon mosinteresim serioz të NJVL-së që t'i informojnë banorët e tyre për punën e Këshillit e me këtë edhe për mënyrën në të cilën merren vendimet.

Rezultatet nga vëzhgimi i suksesshmërisë në aplikimin e standardeve për mbajtjen e procesverbaleve nga mbledhjet e këshillave të NJVL-së

Analiza tregon se ekzistojnë dallime teknike dhe thelbësore në mënyrën e prezantimit të të dhënave në procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të këshillit të NJVL-së, përkatësisht aplikim të ndryshëm të standardeve themelore gjatë mbajtjes së procesverbaleve. Vërejtjet e dhëna nga ana e këshilltarëve gjatë miratimit të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të këshillave të NJVL-së, të cilat ishin lëndë vëzhgimi, gjithashtu tregojnë për dallimet e vërejtura, që shpeshherë nga ana e tyre ishin perceptuar si mangësi.

Në pjesën e mëtejme të raportit është dhënë sqarim për mënyrat e aplikimit të secilit nga 3 standardet kyçe. Gjithashtu, raporti jep pasqyrë për praktikën e mira në bazë të të cilave është kryer renditja, por tregon edhe për mangësitë në aplikimin e tyre.

Standardi I: Evidenca për prezencë në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së

Në fillim të çdo procesverbali duhet të konstatohen faktet me të cilat caktohet se a ka apo nuk ka kuorum për punë për mbledhjen e Këshillit, përkatësisht se Këshilli mund të vendosë me plot të drejtë sipas dispozitave nga ligji, rregullorja për punë dhe statuti i NJVL-së.

Si tregues për suksesshmërinë për aplikimin e standardit Evidenca për prezencë në mbledhje të Këshillit të NJVL-së gjatë renditjes të NJVL-së janë marrë parasysh këto praktika të mira:

- *Shënimi i personit, i cili udhëheq mbledhjen:* Në procesverbal shënohet emri dhe mbiemri i personit që e udhëheq dhe kryeson me mbledhjen e Këshillit (në raste më të shpeshta ky është kryetari i Këshillit).
- *Evidenca e anëtarëve prezentë të Këshillit të NJVL-së:* Në procesverbal evidentohen të gjithë anëtarët prezentë të Këshillit me emër dhe mbiemër.
- *Evidenca e anëtarëve joprezentë të Këshillit të NJVL-së:* Në procesverbal shënohen të gjithë anëtarët joprezentë të Këshillit me emër dhe mbiemër dhe arsyetimi/joarsyetimi i joprezencës së tyre.
- *Evidenca për prezencën e personave të jashtëm të cilët nuk janë anëtarë të NJVL-së:* Në procesverbal shënohen me funksion, emër dhe mbiemër të gjithë personat që nuk janë anëtarë të Këshillit, por kanë të drejtë të jenë prezentë në mbledhje.

Suksesshmëria në aplikimin e **Standardit për evidencë për prezencë në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së** gjatë mbajtjes së procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Këshillit të NJVL-së, është prezantuar përmes rang-listës, veçmas për çdo kategori sipas së cilës janë ndarë NJVL në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Kategoria: Deri 5.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit 9 Komunat në këtë kategori: Novaci, Llozova, Gradsko, Dojrani, Rosomani, Demir Kapia, Vraneshtica, Pllasnica, Zërnovci, Rankovce, Nagoriçani i Vjetër, Konçeja, Zelenikova, Vevçani, Karbinci, Drugova. Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	DRUGOVA	98,7%
	NOVACI	98,2%
	DOJRANI	75,6%
	VRANESHTICA	75,4%
	DEMIR KAPIA	68,0%
	RANKOVCE	67,7%
	KARBINCI	58,3%
	NAGORIÇANI I VJETËR	56,8%
	LLOZOVA	55,0%
	ROSOMANI	52,9%
	VEVÇANI	36,0%
	PLLASNICA	34,7%
	ZËRNOVCI	10,0%
	KONÇEJA	7,1%
GRADSKO	0,0%	

Kategoria: Prej 5.001 deri 10.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 11 Komunat në këtë kategori: Mogilla, Demir Hisari, Çashka, Bogdanci, Mavrova dhe Rostusha, Pehçeva, M. Kamenica, Çeshinova-Oblesheva, Debarca, Krivogashtani, Makedonski Brod, Krusheva, Sopishta, Petroveci, Çuçer-Sandeva, Qendra Zhupa Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	ÇASHKA	80,0%
	ÇESHINOVA-OBLESHEVA	80,0%
	BOGDANCI	78,7%
	MAVROVA DHE ROSTUSHA	72,7%
	DEBARCA	71,8%
	PETROVECI	69,7%
	KRUSHEVA	60,0%
	SOPISHTA	32,1%
	KRIVOGASHTANI	28,7%
	M. KAMENICA	22,0%
	QENDRA ZHUPA	15,7%
	MAKEDONSKI BROD	13,3%
	MOGILLA	12,3%
	PEHÇEVA	6,7%
Kategoria: Prej 10.001 deri 20.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 15 Komunat në këtë kategori: Vallandova, Berova, Dellçeva, Negotini, Oslomeji, Zajazi,	HARAÇINA	100,0%
	ILINDENI	80,0%
	OSLLOMEJI	79,0%

Vinica, Kratova, Resnja, Dollneni, Studeniçani, Haraçina, Ilindeni, Dibra, Novo Sella, Vasileva, Bosillova, Jegunovci, Bërvenica, Probishtipi, Sveti Nikoleja

Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:

DIBRA	77,8%
VESILEVA	66,7%
DOLLNENI	60,0%
VINICA	59,7%
VALLANDOVA	56,4%
DELLÇEVA	53,3%
NOVO SELLA	48,3%
JEGUNOVCI	44,0%
BEROVA	40,0%
BËRVENICA	39,7%
KRATOVA	37,8%
NEGOTINI	36,7%
SVETI NIKOLEJA	30,0%
ZAJAZI	20,0%
RESNJA	20,0%
BOSILLOVA	20,0%
PROBISHTIPI	13,9%
STUDENIÇANI	8,0%

Kategoria: Prej 20.001 deri 40.000 banorë

Numri i anëtarëve të Këshillit: 19

Komunat në këtë kategori: Gjevgjelia, Vrapçishta, Kavadari, Kërçova, Koçana, Kriva Pallanka, Likova, Radovishi, Saraji, Shuto Orizari, Buteli, Tearca, Zhelina, Bogovina

Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:

SARAJI	80,7%
GJEVGJELIA	80,0%
KËRÇOVA	80,0%
RADOVISHI	67,1%
KRIVA PALLANKA	60,0%
KOÇANA	58,8%
ZHELINA	44,4%
BUTELI	41,0%
TEARCA	35,6%
KAVADARI	24,7%
BOGOVINA	20,0%
LIKOVA	16,0%
SHUTO ORIZARI	2,9%
VRAPÇISHTA	0,0%

Kategoria: Prej 40.001 deri 60.000 banorë

Numri i anëtarëve të Këshillit: 23

Komunat në këtë kategori: Velezi, Ohri, Gjorçe Petrovi, Qendra, Kisella Voda, Karposhi, Strumica, Shtipi

Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të

KARPOSHI	91,6%
STRUMICA	58,9%
SHTIPI	55,6%

këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	VELESI	30,0%
	GJORÇE PETROVI	23,1%
	OHRI	7,1%
	KISELLA VODA	3,1%

Kategoria: Prej 60.001 deri 80.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 27 Komunat në këtë kategori: Prilepi, Aerodromi, Çairi, Gazi Baba, Struga Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	AERODROMI	61,4%
	GAZI BABA	61,4%
	STRUGA	46,7%
	ÇAIRI	40,0%
	PRILEPI	7,5%

Kategoria: Prej 80.001 deri 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 31 Komunat në këtë kategori: Manastiri, Gostivari, Tetova Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	MANASTIRI	60,0%
	TETOVA	52,9%
	GOSTIVARI	5,0%

Kategoria: Mbi 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 33 Komunat në këtë kategori: Kumanova, Qyteti i Shkupit Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për prezencë në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	QYTETI I SHKUPIT	63,1%

Gjatë analizimit të procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit është vërejtur përdorimi i praktikave të ndryshme gjatë **evidentimit për prezencë në mbledhjet** e Këshillit të NJVL-së. Këto mënyra të evidentimit të këshilltarëve prezentë dhe joprezentë, si dhe të personave të jashtëm, u shmangen praktikave të mira dhe paraqesin të metë, që në të ardhmen duhet të mënjanohet:

- evidenca përshkruese e anëtarëve prezentë të Këshillit (shumica e këshilltarëve, të gjithë këshilltarët, ka kuorum për punë etj.), përkatësisht në procesverbal nuk janë të shënuar këshilltarët prezentë me emër dhe mbiemër.

- evidenca vetëm për numrin e anëtarëve prezentë të Këshillit, përkatësisht në procesverbal nuk shënohen këshilltarët prezentë me emër dhe mbiemër.

- evidenca vetëm për numrin e anëtarëve joprezentë të Këshillit, përkatësisht në procesverbal nuk shënohen këshilltarët joprezentë me emër dhe mbiemër dhe arsyetimi/mosarsyetimi i joprezencës së tyre.

- në procesverbale nuk evidentohen personat, të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit, ndërsa janë prezentë në mbledhjen ose nuk është shënuar funksioni i tyre apo emri dhe mbiemri.

Raste të mosevidentimit të personave joprezentë dhe të jashtëm në mbledhjet e këshillave të NJVL-së janë mospërputhje të shpeshta të vërejtura gjatë aplikimit të këtij standardi.

Përdorimi i këtyre praktikave nga ana e secilës komunë veçmas është i qasshëm në faqen e internetit www.mojotsovetnik.org.mk.

Standardi II: Evidenca për votim në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së

Gjatë mbledhjes këshilltarët votojnë për miratimin e rendit të ditës, për miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura paraprake, votojnë për pikat nga rendi i ditës, si dhe për propozimet, kërkesat e ndryshme etj. Me shënimin e drejtë të votimit në procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit të NJVL-së, sigurohet arsyetim ligjor i vendimeve të marra etj.

Si tregues për suksesshmërinë në aplikimin e standardit Evidenca për votim në mbledhje të Këshillit të NJVL-së gjatë renditjes së NJVL-së është marrë parasysh kjo praktikë e mirë:

- Evidentimi i të gjitha votave në të gjitha kategoritë – PRO; KUNDËR; I PËRMBAJTUR: Në procesverbal rezultatet nga çdo votim evidentohen me numrin e votave PRO, votave KUNDËR dhe votave TË PËRMBAJTUR.

Suksesshmëria në aplikimin e **Standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së** gjatë mbajtjes së procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Këshillit të NJVL-së, është prezantuar përmes rang-listës veçmas për çdo kategori sipas së cilës janë ndarë NJVL në pajtim më Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Kategoria: Deri 5.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 9 Komunat në këtë kategori: Novaci, Llozova, Gradsko, Dojrani, Rosomani, Demir Kapia, Vraneshtica, Pllasnica, Zërnovci, Rankovce, Nagoriçani i Vjetër, Konçeja, Zelenikova, Vevçani, Karbinci Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha keto rezultate:	NAGORIÇANI I VJETËR	97,7%
	DRUGOVA	95,3%
	PLLASNICA	92,1%
	VRANESHTICA	90,0%
	NOVACI	88,1%
	KONÇEJA	82,7%
	GRADSKO	81,5%
	DEMIR KAPIA	81,2%
	DOJRANI	78,5%
	VEVÇANI	77,6%
	ZËRNOVCI	75,0%
	ROSOMANI	71,4%
	KARBINCI	32,8%
	RANKOVCE	5,7%
	LLOZOVA	3,0%

Kategoria: Prej 5.001 deri 10.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 11 Komunat në këtë kategori: Mogilla, Demir Hisari, Çashka, Bogdanci, Mavrova dhe Rostusha, Pehçeva, M. Kamenica, Çeshinova-Oblesheva, Debarca, Krivogashtani, Makedonski Brod, Krusheva, Sopishta, Petroveci, Çuçer-Sandeva, Qendra Zhupa Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në	BOGDANCI	100,0%
	DEBARCA	98,0%
	M. KAMENICA	97,3%
	SOPISHTA	91,2%
	KRUSHEVA	76,7%
	MOGILLA	72,5%
	QENDRA ZHUPA	54,0%
	KRIVOGASHTANI	46,7%
	ÇASHKA	33,3%
	PEHÇEVA	29,8%
	PETROVECI	17,1%
	MAKEDONSKI BROD	12,9%
	ÇESHINOVA-OBLESHEVA	11,1%

mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	MAVROVA DHE ROSTUSHA	5,6%
--	----------------------	------

Kategoria: Prej 10.001 deri 20.000 banorë		
<p>Numri i anëtarëve të Këshillit: 15 Komunat në këtë kategori: Vallandova, Berova, Dellçeva, Negotini, Oslomeji, Zajazi, Vinica, Kratova, Resnja, Dollneni, Studeniçani, Haraçina, Ilindeni, Dibra, Novo Sella, Vasileva, Bosillova, Jegunovci, Bërvenica, Probishtipi, Sveti Nikoleja</p> <p>Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:</p>	VESILEVA	93,5%
	NOVO SELLA	92,3%
	KRATOVA	89,3%
	RESNJA	74,5%
	DELLÇEVA	70,5%
	BOSILLOVA	68,9%
	SVETI NIKOLEJA	56,3%
	ILINDENI	55,4%
	OSLLOMEJI	49,6%
	PROBISHTIPI	48,6%
	DOLLNENI	42,5%
	DIBRA	42,0%
	JEGUNOVCI	37,5%
	BEROVA	34,9%
	VINICA	26,0%
	NEGOTINI	13,7%
	BËRVENICA	11,5%
VALLANDOVA	4,3%	
STUDENIÇANI	3,7%	
ZAJAZI	0,0%	
HARAÇINA	0,0%	
Kategoria: Prej 20.001 deri 40.000 banorë		
<p>Numri i anëtarëve të Këshillit: 19 Komunat në këtë kategori: Gjevgjelia, Vrapçishta, Kavadari, Kërçova, Koçana, Kriva Pallanka, Likova, Radovishi, Saraji, Shuto Orizari, Buteli, Tearca, Zhelina, Bogovina</p> <p>Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:</p>	RADOVISHI	75,7%
	SHUTO ORIZARI	60,7%
	TEARCA	48,6%
	ZHELINA	45,8%
	BUTELI	31,7%
	GJEVGJELIA	22,8%
	KOÇANA	13,1%
	KAVADARI	13,1%
	BOGOVINA	11,6%
	KRIVA PALLANKA	11,6%
	KËRÇOVA	10,7%
	LIKOVA	7,6%
	SARAJI	2,0%
	VRAPÇISHTA	0,0%
Kategoria: Prej 40.001 deri 60.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 23		
Komunat në këtë kategori: Veleşi, Ohri,		

Gjorçe Petrovi, Qendra, Kisella Voda, Karposhi, Strumica, Shtipi Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		100,0%
	STRUMICA	
	VELESI	66,8%
	OHRI	34,6%
	KARPOSHI	33,2%
	SHTIPI	25,1%
	KISELLA VODA	17,1%
GJORÇE PETROVI	9,2%	

Kategoria: Prej 60.001 deri 80.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 27 Komunat në këtë kategori: Prilepi, Aerodromi, Çairi, Gazi Baba, Struga Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		
	STRUGA	96,9%
	AERODROMI	96,6%
	ÇAIRI	30,1%
	PRILEPI	27,2%
	GAZI BABA	1,4%
Kategoria: Prej 80.001 deri 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 31 Komunat në këtë kategori: Manastiri, Gostivari, Tetova Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		100,0%
	GOSTIVARI	
	TETOVA	16,2%
	MANASTIRI	7,8%

Kategoria: Mbi 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 33 Komunat në këtë kategori: Kumanova, Qyteti i Shkupit Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën për votim në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		
		19,5%

	QYTETI I SHKUPIT	
	KUMANOVA	18,1%

Gjatë analizimit të procesvrebaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit është vërejtur përdorimi i praktikave të ndryshme gjatë **evidentimit për votim në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së**. Këto mënyra të evidentimit të votimeve në baza të ndryshme, u shmangen praktikave të mira dhe paraqesin të metë, që në të ardhmen duhet të mënjanohet:

- Evidentimi vetëm i numrit të votave në një dhe/ose dy kategori – PRO, KUNDËR, I PËRMBAJTUR, përkatësisht në procesverbal nuk evidentohet numri i votave në kategorinë/të tjetër/a.
- Evidentimi i rezultateve nga votimi me "njëzëri", përkatësisht në procesverbal nuk shënohet numri i votave PRO ose KUNDËR dhe nuk dihet numri i këshilltarëve prezentë në momentin e votimit.
- Evidentimi i rezultateve nga votimi me "shumicën e votave", përkatësisht në procesverbal nuk shënohet numri i votave PRO, KUNDER, I PËRMBAJTUR.

Nga analiza, gjithashtu mund të vërehet se te një numër i madh i komunave, të cilat kanë evidentuar votimin me numër votash, ekziston mospërputhje në mes numrit të votave dhe numrit të këshilltarëve prezentë në fillim të mbledhjes. Mbetet dilema se a janë evidentuar të gjitha votat ose ndonjë nga këshilltarët nuk ka votuar ose nuk ka qenë prezent gjatë kohës së votimit. Kjo praktikë paraqet të metë, e cila në të ardhmen duhet të mënjanohet.

Votimi me emër

Në pajtim me rregulloret për punën e Këshillave të NJVL-së, anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të kërkojnë që të realizohet votimi me emër në raste të ndryshme në mbledhjet e këshillave të NJVL-së.

Si tregues për suksesshmërinë në aplikimin e standardit, Votim me emër në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së është marrë parashysh praktika e mirë kur në procesverbal shënohen emri dhe mbiemri i të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe prononcimi i tyre gjatë votimit.

MOST-i thekson se kjo është e domosdoshme sipas rregulloreve për punë të këshillave të NJVL-së kur bëhet fjalë për votim me emër.

Praktika e mirë e evidentimit të votimit me emër është vërejtur te këto komuna: Çeshinova-Oblesheva, Makedonski Brod, Petroveci, Vasileva, Ohri, Karposhi, Aerodromi.

Gjatë analizimit të procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave, është vërejtur evidentimi i votimit me emër vetëm me numrin e votave, pa i shënuar të gjithë anëtarët e Këshillit me emër dhe mbiemër dhe prononcimin e

tyre gjatë votimit. Kjo mënyrë e evidentimit të votimit me emër i shmanget praktikës së mirë dhe paraqet të metë, e cila në të ardhmen duhet të mënjanohet.

Komunat ku më shpesh përdoret praktika e evidentimit të votimit me emër vetëm me numër votash në procesverbal janë këto: Krusheva, Negotini, Ilindeni, Koçana, Shtipi, Karposhi, Struga, Qyteti i Shkupit dhe Kumanova.

Mënyra e aplikimit të këtij standardi për secilën komunë veçmas është e qasshme në faqen e internetit www.mojotsovetnik.org.mk.

Standardi III: Evidenca e fjalimit të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së

Në procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit duhet të jenë të shënuara fjalimet e të gjithë diskutuesve me funksion, emër dhe mbiemër të diskutuesit dhe përmbajtje e shkurtër, përkatësisht momentet/poentat më të rëndësishme të fjalimit. Gjithashtu, sipas rregulloreve për punë të NJVL-së, anëtari i Këshillit mund të kërkojë që në procesverbal të shënohen pjesët më të rëndësishme të fjalimit të tij.

Si tregues për suksesshmërinë në aplikimin e standardit Evidenca e fjalimit në mbledhjet e Këshillit të NJVL-së gjatë renditjes së NJVL-së është marrë parasysh kjo praktikë e mirë:

- *Fjalimi i shënuar me emër dhe mbiemër të diskutuesit dhe përmbajtja e fjalimit të tij:* Në procesverbalin evidentohet diskutuesi me emër dhe mbiemër, si dhe përmbajtja e shkurtër e fjalimit, përkatësisht momentet/poentat më të rëndësishme të fjalimit.

Suksesshmëria në aplikimin e **Standardit për evidencë të fjalimit të këshilltarëve në Këshillin e NJVL-së** gjatë mbajtjes së procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Këshillit të NJVL-së, është prezantuar përmes rang-listës veçmas për çdo kategori sipas të cilave janë ndarë NJVL në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Kategoria: Deri 5.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 9 Komunat në këtë kategori: Novaci, Llozova, Gradsko, Dojrani, Rosomani, Demir Kapia, Vraneshtica, Pllasnica, Zërnovci, Rankovce, Nagoricani i Vjetër, Konçeja, Zelenikova, Vevçani, Karbinci Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	KARBINCI	99,8%
	DRUGOVA	98,9%
	LLOZOVA	97,9%
	VRANESHTICA	96,2%
	DEMIR KAPIA	94,0%
	RANKOVCE	90,8%
	GRADSKO	89,3%
	ZËRNOVCI	88,0%
	NAGORICANI I VJETËR	87,8%
	DOJRANI	84,7%
	KONÇEJA	82,7%
	PLLASNICA	69,7%
	VEVÇANI	66,7%
	NOVACI	65,8%
ROSOMANI	51,9%	

Kategoria: Prej 5.001 deri 10.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 11 Komunat në këtë kategori: Mogilla, Demir Hisari, Çashka, Bogdanci, Mavrova dhe Rostusha, Pehçeva, M. Kamenica, Çeshinova-Oblesheva, Debarca, Krivogashtani, Makedonski Brod, Krusheva, Sopishta, Petroveci, Çuçer-Sandeva, Qendra Zhupa Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	SOPISHTA	99,5%
	PETROVECI	97,9%
	MAVROVA DHE ROSTUSHA	97,3%
	DEBARCA	95,3%
	ÇESHINOVA-OBLESHEVA	94,1%
	KRIVOGASHTANI	93,9%
	KRUSHEVA	92,5%
	ÇASHKA	89,1%
	BOGDANCI	88,2%
	QENDRA ZHUPA	80,6%
	MOGILLA	69,2%
	PEHÇEVA	69,1%
	MAKEDONSKI BROD	62,6%
	M. KAMENICA	58,2%

Kategoria: Prej 10.001 deri 20.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 15 Komunat në këtë kategori: Vallandova, Berova, Dellçeva, Negotini, Oslomeji, Zajazi, Vinica, Kratova, Resnja, Dollneni, Studeniçani, Haraçina, Ilindeni, Dibra, Novo Sella, Vasileva, Bosillova, Jegunovci, Bërvenica, Probishtipi, Sveti Nikoleja Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	HARAÇINA	100,0%
	VASILEVA	100,0%
	BOSILLOVA	100,0%
	KRATOVA	99,8%
	DIBRA	99,1%
	ILINDENI	98,8%
	STUDENIÇANI	98,3%
	SVETI NIKOLEJA	98,1%
	DELLÇEVA	96,6%
	ZAJAZI	95,2%
	RESNJA	94,5%
	VALLANDOVA	94,3%
	NOVO SELLA	91,5%
	VINICA	91,0%
	BEROVA	90,0%
	NEGOTINI	88,8%
	PROBISHTIPI	85,1%
DOLLNENI	82,0%	
JEGUNOVCI	72,7%	
BËRVENICA	59,4%	
OSLLOMEJI	56,8%	

Kategoria: Prej 20.001 deri 40.000 banorë
--

<p>Numri i anëtarëve të Këshillit: 19 Komunat në këtë kategori: Gjevgjelia, Vrapçishta, Kavadari, Kërçova, Koçana, Kriva Pallanka, Likova, Radovishi, Saraji, Shuto Orizari, Buteli, Tearca, Zhelina, Bogovina</p> <p>Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:</p>	RADOVISHI	98,5%
	KAVADARI	98,4%
	TEARCA	95,8%
	LIKOVA	95,4%
	SARAJI	92,1%
	BOGOVINA	90,8%
	SHUTO ORIZARI	88,7%
	BUTELI	86,2%
	ZHELINA	83,6%
	KËRÇOVA	81,7%
	VRAPÇISHTA	74,7%
	KOÇANA	68,4%
	KRIVA PALLANKA	63,8%
	GJEVGJELIA	21,7%

Kategoria: Prej 40.001 deri 60.000 banorë		
<p>Numri i anëtarëve të Këshillit: 23 Komunat në këtë kategori: Velesi, Ohri, Gjorçe Petrovi, Qendra, Kisella Voda, Karposhi, Strumica, Shtipi</p> <p>Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:</p>		
	STRUMICA	100,0%
	KARPOSHI	92,0%
	GJORÇE PETROVI	77,4%
	OHRI	76,4%
	SHTIPI	53,2%
	VELESI	15,7%
	KISELLA VODA	2,6%

Kategoria: Prej 60.001 deri 80.000 banorë		
<p>Numri i anëtarëve të Këshillit: 27 Komunat në këtë kategori: Prilepi, Aerodromi, Çairi, Gazi Baba, Struga</p>		

Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:	GAZI BABA	99,4%
	PRILEPI	94,9%
	ÇAIRI	88,5%
	AERODROMI	88,2%
	STRUGA	86,5%

Kategoria: Prej 80.001 deri 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 31 Komunat në këtë kategori: Manastiri, Gostivari, Tetova Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		
	MANASTIRI	100,0%
	TETOVA	87,7%
	GOSTIVARI	72,5%

Kategoria: Mbi 100.000 banorë		
Numri i anëtarëve të Këshillit: 33 Komunat në këtë kategori: Kumanova, Qyteti i Shkupit Në këtë kategori, analiza e procesverbaleve të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të këshillave për suksesshmërinë në realizimin e standardit për evidencën e fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit, i dha këto rezultate:		
	KUMANOVA	46,7%
	QYTETI I SHKUPIT	33,8%

Gjatë analizimit të procesverbaleve, të dërguar nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit, është vërejtur përdorimi i praktikave të ndryshme gjatë **evidentimit të fjalimeve të diskutuesve në mbledhjet e Këshillit**. Këto menyra të evidentimit të fjalimeve të diskutuesve në raste të ndryshme u shmangen praktikave të mira dhe paraqesin të meta, të cilat në të ardhmen duhet të mënjanohen:

- Shënimi i emrit dhe mbiemrit të diskutuesit/sve, pa përmbajtje të fjalimit/eve, përkatësisht në procesverbalin nuk shënohet përmbajtja e fjalimit të diskutuesit.
- Shënimi në grupe të diskutuesve me emër dhe mbiemër pa përmbajtje të fjalimeve, përkatësisht në procesverbalin shënohen emrat dhe mbiemrat e më shumë diskutuesve, të cilët kanë marrë pjesë në ndonjë diskutim në mbledhje pa u evidentuar fjalimet e tyre.
- Shënimi i përmbajtjes së fjalimit pa i shënuar diskutuesit, përkatësisht në procesverbalet nuk është shënuar emri dhe mbiemri i diskutuesit.
- Shënimi i emrave të më shumë diskutuesve dhe një përmbajtje e përbashkët e fjalimeve, përkatësisht në procesverbalin është shënuar një përmbajtje e përbashkët e shkurtër si fjalim i më shumë diskutuesve.

Si dukuri negative mund të ceket praktika e mosshënimit të diskutuesit/sve, me emrin dhe mbiemrin e tyre dhe përmbajtjen e fjalimeve. Domethënë, në procesverbalin shënohet se në diskutim për ndonjë pikë ka pasur diskutues, por nuk është shënuar emri dhe mbiemri i tyre e as përmbajtja e fjalimit të tyre.

Brengos fakti se gjatë miratimit të procesverbaleve nga mbledhjet paraprake, një pjesë e madhe e këshilltarëve nuk janë të interesuar të ndikojnë për mënyrën në të cilën fjalimi i tyre është regjistruar.

Mënyra e aplikimit të këtij standardi për secilën komunë veçmas është e qasshme në faqen e internetit www.mojotsovetnik.org.mk.

Pyetjet e këshilltarëve

Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të parashtojë pyetje për kryetarin, anëtarët e organeve drejtuese të shërbimeve publike, entet dhe ndërmarrjet që i themelon komuna, të cilat kanë të bëjnë me punën e tyre ose me punën që është në kompetencën e tyre.

Pyetjet mund të parashtrihen gojarisht në mbledhjen e Këshillit të NJVL-së, ose në formë të shkruar në periudhën në mes dy mbledhjeve të Këshillit. Gjithashtu, personat të cilëve u parashtrihen pyetjet, përgjigjet e tyre mund t'i japin gojarisht në mbledhjen e Këshillit ose përgjigjen do ta dërgojnë me shkrim.

Si tregues për suksesshmërinë e Evidencës të pyetjeve të këshilltarëve, janë marrë këto elemente:

- përmbajtje e shkurtër dhe e saktë e pyetjes së parashtruar,
- përmbajtje e shkurtër dhe e saktë e përgjigjes,

Është i madh numri i komunave të cilat i kanë regjistruar pyetjet e parashtruara nga ana e këshilltarëve, por nuk janë evidentuar përgjigjet e këtyre pyetjeve. Dilema është se a nuk janë regjistruar përgjigjet në procesverbal ose a janë përgjigjur pyetjet nga personi nga i cili është kërkuar përgjigja. Nga procesverbalet

e marra praktika e këtillë është përdorur në mënyrë të konsiderueshme në komunën e Kisella Vodës, Krushevës, Kumanovës, Velesit dhe Zhelinës.

Gjithashtu, vetëm në një komunë, përkatësisht në Karbinci, si pjesë e procesverbaleve janë edhe pyetjet e parashtruara për të cilat është kërkuar përgjigje me shkrim, bashkë me përgjigjet e dhëna me shkrim që u janë dërguar shërbimeve në komunë.

Mënyra e aplikimit të këtij standardi për secilën komunë veçmas është e qasshme në faqen e internetit www.mojotsovetnik.org.mk.